



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18 dhe nenit 6 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/ 111-400, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR MBËSHTETJE DHE OFRIM TË NDIHMAVE NGA KATEGORIA E MJETEVE BUXHETORE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

Për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

1. Selman Gashi, kryesues
2. Fitore Blakçori anëtare

Anëtar i tretë i Komisionit, varësisht kërkesave të paraqitura Drejtorive përkatëse, është:

- Xhevat Llugaliu, Drejtorja e Arsimit
- Zenel Zeneli, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mëirëqenjes Sociale
- Venoza Zullufi, Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit
- Xhafer Sekiraqa, Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Mandati i Komisionit është deri më 31 dhjetor 2020.


Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me nenin 7 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0011787/19
Podujevë,
08 shkurt 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës(vendimi nr. 02/141, datë 07.04.2017), merr:

VENDIM THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES

Neni 1

Themelohet Komiteti Veprues në Komunën e Podujevës, në përbërje:

1. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës - kryesues
2. Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit - anëtar
3. Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - anëtar
4. Zenel Zeneli, shef i sektorit për Mirëqenie Sociale - anëtar
5. Naime Podvorica, zyrtare për barazi Gjinore - anëtare
6. Isuf latifi, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa - anëtar
7. Ahmet Ahmeti, zyrtar për të Drejtat e Njeriut – anëtar
8. Liman Zeqiri, shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim – anëtar
9. Xhafer Ademi, OJQ “ Qëndrimi” - anëtar

Neni 2

Qëllimi i themelimit të Komitetit Komunal Veprues është monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 për Komunën e Podujevës, si dhe të shërbej si strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të mirë në kuadër të procesit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:
Anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues
Arkivit*

Nr.02-060/01-0014406/19
Podujevë, 19 shkurt 2019





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 24 të Rregullores (QRK) 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, merr,

VENDIM PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR KTHIM

Neni 1

Themelohet Komisioni Komunal për Kthim, në këtë përbërje:

- | | |
|---|----------|
| 1. Liman Zeqiri, <i>shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,</i> | kryesues |
| 2. Ardian Emini, <i>Drejtorja e Arsimit,</i> | anëtar |
| 3. Arbresha Bashota, <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,</i> | anëtare |
| 4. Naim Potoku, <i>Qendra për Punë Sociale,</i> | anëtar |
| 5. Naime Ajeti, <i>Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit,</i> | anëtare |
| 6. Doruntina Sollova, <i>Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtës së Mjedisit,</i> | anëtare |
| 7. Labinot Murati, <i>Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë,</i> | anëtar |
| 8. _____, përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, | anëtar |

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësit i ushtron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren (QRK) 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, si dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi, është 3 vite.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Anëtarëve të Komisionit
Ministrisë për Komunitete dhe Kthim,
Arkives

Nr. 02-020/04-001558319
Podujevë, 21 shkurt 2019

Kryetari i Komunës
Agim Veliu